

SHKOLLA PËR AKTIVIZËM

Titulli: Shkolla për Aktivizëm

Kohëzgjatja: 2 muaj
Çdo modul është dizajnuar për t'u organizuar në tre ditë të plota. 20-22 orë për secilin modul.

Moduli 1 (Qeverisja e brendshme dhe menaxhimi financiar për OShC): 5, 6 dhe 7 dhjetor 2023

Moduli 2 (Integrimi Gjinator): 11, 12 dhe 13 dhjetor 2023

Moduli 3 (Sistemet dhe proceset për vlerësimin e ndikimit dhe ngritje të fondeve): 16, 17 dhe 18 janar 2024

Moduli 4 (Avokimi pjesëmarrës): 23, 24 dhe 25 janar 2024

Moduli 5 (Teknikat e mobilizimit të komunitetit): 30, 31 janar dhe 1 shkurt 2024

Data e fundit për aplikim Afati për aplikim është i hapur deri me 20 nëntor 2023, në ora 23:59

Objektivat: Shkolla për Aktivizëm është një program vjetor i ngritjes së kapaciteteve që do të shërbejë si një hapësirë për edukimin profesional të OSHC-ve dhe rritje të aktivizimit e cila ka për qëllim zhvillimin e shkathtësive, dhe rritjen e kompetencës së OSHC-ve të vogla, të mesme, dhe me bazë në komunitet për të rritur prezencën e tyre në komunitetin në të cilën operojnë dhe në proceset e politikëbërjes, duke ndjekur parimet e avokimit pjesëmarrës dhe transparencës. Kurrikula dhe ofrimi i programit është hartuar duke përdorur një qasje holistike ku OSHC-të e përzgjedhura do të marrin pjesë në trajnime dhe seminare për ngritjen e kapaciteteve mbi (1) Qeverisjen e brendshme dhe menaxhimin financiar (2) Integrimin gjinator (3) Sistemet dhe proceset për vlerësimin e ndikimit dhe ngritje të fondeve (4) Avokimin pjesëmarrës dhe (5) Teknikat e mobilizimit të komunitetit.

Pjesëmarrësit: Çdo vit një grup prej 20 deri 25 OSHC që përfaqësojnë komunitete të ndryshme, nga rajone të ndryshme gjeografike përzgjidhen për të ndjekur shkollën bazuar në kriteret.

- Të jenë Organizatë e Shoqërisë Civile, të regjistruara në Kosovë;
- Të jenë Organizatë e Shoqërisë Civile që veprojnë kryesisht në nivel lokal;
- Të ketë aktivitet në komunitet dhe/ose interesim për përfshirje të qytetarëve/eve në punën e organizatës;
- Të kenë identifikuar si nevojë zhvillimin e dokumenteve të ndryshme të brendshme në përmirësimin e procedurave dhe rregulloreve për funksionim të organizatës;

Rezultati:

Me pjesëmarrjen e OSHC-ve në Shkollën e Aktivizimit, çdo OSHC pjesëmarrëse do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë më mirë organizimin, qeverisjen së brendshme menaxhimin financiar të organizatës;
- Të përdorë forma dhe mjete të përshtatshme për identifikim të nevojave të komunitetit për të cilin angazhohen;
- Të hartojë një strategji apo plan të qartë të aktivitetit për realizim të qëllimeve të organizatës;
- Të përfshijë integrimin gjinor në kuadër të aktiviteteve të brendshme dhe me palë të jashtë organizatës;
- Të krijojë strategji më të mirë për ngritjen e fondeve, planifikimin dhe implementimin e projektit;
- Të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes, në nivel lokal dhe qendror, me njohuri më të mira të metodave të avokimit pjesëmarrës;
- Të kuptojë më mirë dhe të jetë më kompetente në aplikimin e teknikave të mobilizimit të komunitetit;
- Krijojnë rrjet të organizatave dhe bashkëpunim me grupe të ndryshme për interesat dhe qëllime të përbashkëta të organizatës.

Gjatë pjesëmarrjes në Shkollën për Aktivizëm dhe pas përfundimit të Shkollës pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të përfitojnë:

- Mentorim dhe këshillim të vazhdueshëm nga ekspertë të angazhuar nga Qendra për adresim dhe avancim të çështjeve specifike të organizatës;
- Rrjetëzim dhe bashkëpunim me organizata tjera të shoqërisë civile për angazhim të përbashkët në nisma avokuese, adresim të nevojave të komunitetit, etj.

Metodologjia:

- Ligjërata
- Prezantime
- Ushtrime
- Vizita në terren
- Detyrë individuale dhe grupore
- Materiale vizuale
- Folës të ftuar

Gjatë pjesëmarrjes në Shkollën për Aktivizëm dhe pas përfundimit të Shkollës, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të përfitojnë:

- Mentorim dhe këshillim të vazhdueshëm nga ekspertë të angazhuar nga Qendra për adresim dhe avancim të çështjeve specifike të organizatës;
- Rrjetëzim dhe bashkëpunim me organizata tjera të shoqërisë civile për angazhim të përbashkët në nisma avokuese, adresim të nevojave të komunitetit, etj.

Data

Modulet

**5, 6, 7
dhjetor
2023**

Moduli 1- Qeverisja e brendshme dhe menaxhimi financiar për OShC

- Kuptimi, përcaktimi dhe dallimi i Qeverisjes dhe Menaxhimit
- Cikli jetësor i organizatës
- Bazat e Menaxhimit Financiar
- Bazat e buxhetimit
- Raportimi dhe Menaxhimi Financiar për OSHC-të

**11, 12 dhe 13
dhjetor
2023**

Moduli 2: Integrimi gjinor

- Koncepte të rëndësishme të integritit gjinor;
- Aplikimi i integritit gjinor në punën në organizatë;
- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e këtyre koncepteve në zhvillimin e dokumenteve të brendshme të organizatës;
- Integrimi gjinor gjatë hartimit të projekteve, duke përfshirë analizën gjinore; hartimi i objektivave, treguesve, aktiviteteve dhe rezultateve; monitorimi dhe vlerësimi.

**16, 17, 18
janar
2024**

Moduli 3: Sistemet dhe proceset për vlerësimin e ndikimit dhe ngritje të fondeve

- Informacion rreth shpjegimit të arsyeshem, potencialeve dhe sfidave të monitorimit dhe vlerësimit për vlerësimin e ndikimit;
- Identifikimi i konteksteve dhe qëllimeve të ndryshme të M&E;
- Mësimi i procesit sistematik për zhvillimin e sistemeve të M&V në nivel projekti dhe programi dhe marrëdhëniet e tyre me objektivat dhe misionin e organizatës;
- Identifikimi i një sërë opsionesh për ngritjen e fondeve;
- Strategjitë për identifikimin e akterëve potencialë për ngritjen e fondeve
- Si të përdoren të dhënat e monitorimit dhe vlerësimit për qëllime të ngritjes së fondeve

**23, 24, 25
janar
2024**

Moduli 4: Avokimi pjesëmarrës

- Demokracia dhe avokimi pjesëmarrës;
- Përfshirja e komunitetit në punën e OSHC-ve;
- Cikli i politikë bërjes;
- Roli i qytetarëve në proceset e politikë bërjes dhe vendimmarrjes;
- Mekanizmat kryesorë formalë për pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë bërje në nivel lokal dhe qendror;
- Mekanizmat ekzistues dhe pikat hyrëse për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e integritit të Kosovës në BE

**30, 31
janar dhe
1 shkurt
2024**

Moduli 5: Teknikat e mobilizimit të komunitetit

- Përkufizimi i komunitetit dhe dimensionet e tij;
 - Mobilizimi i komunitetit, rrjetëzimi dhe ndërtimi i koalicionit;
 - Teknikat për zhvillimin e dialogut të vazhdueshëm ndërmjet anëtarëve të komunitetit dhe përfaqësuesve të OSHC-ve;
 - Metodat dhe teknikat për fuqizimin e qytetarëve për të adresuar nevojat e tyre dhe të komunitetit
 - Përfitimet e mobilizimit të komunitetit dhe roli i mobilizuesve të komunitetit
- Njohja me planet e komunikimit dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe mjetet për komunikim efektiv.

Ju lutem vini re se datat e vendosura për realizimin e moduleve janë tentative dhe mund të ndryshojnë. Për çdo ndryshim eventual do të jeni të informuar me kohë.